



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 638/1 prot.

Tiranë më 18. 4.2018

Lënda: Kthim përgjigje ndaj ankimit për mosrespektimin e procedurave ligjore mbi procesin e njoftimit dhe konsultimin publik

QËNDRËS “RES PUBLICA”

Tiranë

Pasi u njohëm me ankesën tuaj nr. 638 Prot., datë 10.04.2018, Zyra e Komisionerit konstaton se në rastin objekt shqyrtimi, procedurat e kërkuara nga ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” nuk janë përmbushur në mënyrën që ky ligj parashikon për organet publike në kuadër të procesit të konsultimit.

Çdo organ publik gjatë fazës së njoftimit dhe konsultimit duhet të zbatojë detyrimet kryesore të parashikuara në nenin 6 dhe 7 të ligjit nr. 146/2014, “...publikimit në regjistrin elektronik të projektaktit...” e duke vazhduar me masat vijuese, si afatet kohore (neni 15 i ligjit) etj.

Parashikimet e mësipërme janë disa detyrime ligjore të cilat përcaktojnë rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.

Ligji nr.146/2014, në pikën 1, të nenit 21 parashikon se:

“Nëse palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cenuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, si dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në nenet 15 dhe 17 të këtij ligji, mund të ankohen;

a) pranë titullarit të organit publik përgjegjës për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, kur projektakti nuk është miratuar ende;

b) pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të aktit.

Për sa më sipër, Komisioneri nga njohja me faktet e paraqitura, vlerëson se *projektligji "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës"*, nuk është miratuar ende, për këtë arsye gjendemi para zbatimit të shkronjës a), të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr.146/2014.

Në rastin objekt ankese, palët e interesuara mund të ankohen pranë titullarit të organit publik përgjegjës për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, dhe jo pranë Zyrës së Komisionerit.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

